



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.1114/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë për shkak të vendosje së materialit zgjedhor në hapësire publike – trafo elektrike, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.11.2021, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa A.nr.1114/2021 e datës 12.11.2021, e paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë për shkak të vendosje e materialit zgjedhor në hapësire publike – trafo elektrike, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021.

A r s y e t i m

Me datën 12.11.2021, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datën 11.11.2021 në ora 16:00, aktivistët e subjektit të tyre kanë vërejtur se Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK) për qëllime elektorale në rrugën “ Fatmir Hyseni” në Podujevë përkatësisht në trafo elektrike ka vendosur material zgjedhor (poster të kandidatit të tyre për Kryetar të Komunës së Podujevës Ekrem Hyseni), këto veprime të Subjektit Politik janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes dhe janë të sanksionuara në nenin 33 pika b) të LZP-së. Andaj duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartë cekura kërkojmë që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore, ankesuesi ka bashkangjitur një fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

PZAP-i me datën 12.11.2021, ka dërguar Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kërkesën për përgjigje në ankesë në të cilën i ka kërkuar që të përgjigjet deri me datë 13.11.2021 deri në ora 10:00.

Në përgjigjen në ankesë, Subjekti Politik, Lidhja Demokratike e Kosovës, të datës 13.11.2021, kanë theksuar se e kundërshtojnë pretendimin e Subjektit Politik LVV, ngase një foto e tillë nuk provon diçka konkrete, fillimisht nuk dihet se a është apo jo trafo elektrike, si dhe veprimin si në foto nuk shihet se a është bërë nga ndonjë aktivist i LDK-së, po ashtu nuk shihet se kur është vendosur një poster i tillë, çka e paragjykon edhe faktin e kohës së vendosjes, siç

theksojnë se veprimin e tillë kanë mund ta bëjnë edhe kundërshtarët e tjerë politik. Në vazhdim të përgjigjes Subjekti Politik LDK konteston themelësinë e kësaj ankese për arsye se pretendimet e ankuesit janë të rrezueshme, për faktin se në këtë hapësirë ku është vendosur posteri, apo veprimi i tillë nuk dëshmon APRIORI se i njejti është bërë nga ndonjë mbështetës i LDK-së, apo kandidati për kryetar komune Ekrem Hyseni.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka vendosur material zgjedhor përkatësisht poster të kandidatit të tyre për Kryetar të Komunës së Podujevës, në trafo elektrike në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, janë të pabazuara, dhe nuk përbëjnë shkelje pasi që në fotografinë e bashkangjitur në ankesë nuk shihet se e njëjta është trafo elektrike ashtu siç pretendohet në ankesë Sipas Rregullës NR.02/20215 Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 5.7 ankesat duhet të kenë së paku informacione si b) *Një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën, kohën dhe vendin shkeljes së pretenduar*, ku në rastin konkret parashtruesi i ankesës nuk ka dhënë hollësi që të dihet se kur dhe ku është vendosur.

Andaj paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar kanë material zgjedhor material zgjedhor, në hapësira të palejuara konkretisht në trafo elektrike, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1114/2021 më datën 15.11.2021

Kryesuese e Panelit

Milena Đerić



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 1 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.